

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN

“PËR TREGTIMIN E PRODUKTEVE QË MUND TË PËRDOREN PËR DËNIME KAPITALE, TORTURË OSE DËNIME APO TRAJTIME ÇNJERËZORE OSE DEGRADUESE”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj ka për qëllim rregullimin e tregtimit të produkteve që mund të përdoren për dënime kapitale, torturë ose dënime apo trajtime çnjerëzore ose degraduese. Deri më tani tregtimi i këtyre produkteve është i parregulluar, duke krijuar hapësira për importin, eksportin dhe prodhimin e tyre në tregun shqiptar. Rregullimet e propozuara në këtë projektligj kufizojnë këtë treg dhe e rregullojnë atë, duke e kushtëzuar tregtimin e këtyre produkteve me një regjim autorizimesh, që do të lëshohen nga AKSHE-ja.

Produktet që përfshihen në fushën e veprimit të këtij projektligji janë të llojeve të ndryshme dhe do të kategorizohen në 2 grupime, për efekt të regjimit që ndiqet për secilën kategori. Në kategorinë e parë gjenden produktet të cilat nuk kanë përdorim praktik, përveç ushtrimit të trajtimeve çnjerëzore dhe degraduese. Këto sende nuk lejohet të prodhohen, eksportohen ose importohen në vendin tonë, përveç rasteve të ekspozimeve në muze. Në kategorinë e dytë gjenden produkte, të cilat kanë edhe përdorime të tjera, por që mund të përdoren edhe për dhënien e trajtimeve çnjerëzore dhe degraduese. Këto produkte mund të prodhohen, importohen ose eksportohen me autorizim të lëshuar nga autoriteti përgjegjës për kontrollin shtetëror të eksporteve.

Gjithashtu, ky projektligj synon të rregullojë edhe furnizimin me shërbime të ndërmjetësimit, ndihmës teknike, trajnimit dhe reklamën në lidhje me produktet e sipërcituara. Edhe këto shërbime do të jenë të grupuara sipas kategorive të produkteve të cilave i referohen dhe do të ndjekin të njëjtin regjim me to. Pra, shërbimet për produkte të cilat nuk kanë përdorim tjetër praktik, janë të ndaluara kategorikisht, ndërsa për produktet të cilat janë subjekt autorizimi nga AKSHE-ja edhe shërbimet për to, do të jenë subjekt autorizimi.

Ky projektligj gjithashtu do të normojë procedurën e kërkesës për t’u pajisur me autorizim, afatet dhe masat administrative për shkeljen e dispozitave të projektligjit.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave, për vitin 2021, për Ministrinë e Mbrojtjes, i

cili është miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1121, datë 30.12.2020, si dhe do të shtyhet për shkak të konsultimit me organet e Komisionit Evropian, të cilët e kanë përzgjedhur përafrimin e kësaj direktive për të ushtruar një kontroll mbi përafrimin e Rregullores (BE) 2019/125, të Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16.1.2019 “Për tregtinë e disa mallrave që mund të përdoren për dënimin me vdekje, torturën apo trajtime ose dënime të tjera mizore, çnjerëzore apo trajtime ose dënime poshtëruese”. Numri CELEX 32019R0125, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 30/1, datë 31.1.2019 faqe 1-57, i ndryshuar.

Gjithashtu, projektligji është parashikuar në Programin Kombëtar të Integritimit Evropian për 2021-2023, i cili është miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 90, datë 17.2.2021.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Fusha e tregtisë së mallrave dhe shërbimeve të cilat nuk kanë përdorim tjetër, përveç për ekzekutimin e dënimit me vdekje, torturave dhe trajtimeve dhe dënimeve të tjera mizore, degraduese ose çnjerëzore nuk është e rregulluar në Republikën e Shqipërisë. Këto mallra mungojnë në listat e kontrollit të eksportit ushtarak, ato me përdorim të dyfishtë ose të mallrave tjera strategjike.

Kombet e Bashkuara kanë ndaluar në formë absolute torturën (Rezoluta e OKB-së, e miratuar nga Asambleja e Përgjithshme, në 18 Dhjetor 2019, A / RES / 74/143. Tortura dhe trajtime ose ndëshkime të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese). Gjithashtu, Karta e të Drejtave Themelore të Bashkimit Evropian (Karta) ka ndaluar dënimin me vdekje ose nënshtrimin ndaj torturave ose trajtimeve çnjerëzore ose poshtëruese ose dënimeve.

Neni 5, i Deklaratës Universale të Drejtave të Njeriut, neni 7, i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike dhe neni 3, i Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore, të gjithë përcaktojnë një ndalim të pakushtëzuar, gjithëpërfshirës të torturës dhe trajtimit ose çfarëdo ndëshkimi mizor, çnjerëzor ose poshtërues. Parashikime të tjera, në veçanti Deklarata e Kombeve të Bashkuara për Mbrojtjen e të Gjithë Personave nga Nënshtrimi ndaj Torturës dhe Trajtimeve ose Dënimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese (4) dhe Konventa e vitit 1984 e Kombeve të Bashkuara Kundër Torturës dhe Trajtimeve apo Ndëshkimeve të Tjera Mizore, Çnjerëzore ose Poshtëruese, vendosin për një detyrim shteteve për të parandaluar torturën.

Brenda Shqipërisë importimi i mallrave, të cilat nuk kanë përdorim tjetër, përveç për ekzekutimin e dënimit me vdekje, torturave dhe trajtimeve ose ndëshkimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese, por edhe sigurimi i ndihmës teknike për këto mallra, nuk është i kontrolluar. Këto mallra mund të prodhohen apo tregtohen pa autorizim apo licencim. Gjithashtu, këto mallra mund të shiten pa kufizim të të gjithë qytetarët.

Eksporti apo kalimi transit i mallrave të cilat nuk kanë përdorim tjetër, përveç për ekzekutimin e dënimit me vdekje, torturave dhe trajtimeve ose ndëshkimeve të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese, por edhe sigurimi i ndihmës teknike në vende të treta, që nuk janë

pjesë e Bashkimit Evropian, nuk kanë rregullime apo kufizime. Mungesa e këtyre kufizimeve mund të cenojë sigurinë njerëzore, pasi këto produkte/shërbime mund të përdoren për torturë apo dënime kapitale në vende të treta.

Sistemi i kontrollit të eksportit të BE-së zbaton standarde të larta të kontrolleve dhe shërben si pikë referimi për shumë vende të botës, përfshirë edhe Shqipërinë. Kontrollat me përdorim të dyfishtë plotësojnë drejtpërdrejt kontrollat mbi eksportet e armëve dhe ndjekin objektiva kryesisht të ngjashëm. Masat kufizuese (sanksionet) luajnë një rol të rëndësishëm në luftimin e përhapjes së armëve luftarake të armëve luftarake dhe terrorizmit, dhe gjithashtu promovojnë sigurinë rajonale dhe të drejtat e njeriut.

Rregullore ose direktiva të tjera gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në rregullimin e tregtisë së sendeve të ndjeshme. Secila prej këtyre rregulloreve/direktivave merret ose me një kategori specifike dhe të ndryshme të artikujve dhe/ose përdorimet e fundit, ose adreson lloje të ndryshme të situatave.

Eksportet e artikujve me përdorim të dyfishtë mund të ndikojnë gjithashtu në të drejtat themelore, veçanërisht ato të njerëzve në vendet jo BE, të tilla si e drejta për jetë dhe ndalimi i torturës dhe trajtimit çnjerëzor dhe degradues, e drejta për siguri etj. Rregullorja (KE) 125/2019 (Rregullorja “Kundër torturës”) adreson në mënyrë specifike tregtinë që mund të keqpërdoret për të privuar një person nga jeta, përdorimi i të cilave mund ta ekspozojë një person ndaj torturave gjatë kufizimit të lirisë, kontrollit, trazirave ose vetëmbrojtjes.

Mallrat që mund të përdoret për dënime kapitale ose për torturë mund të kategorizohen në 2 grupe të mëdha:

- mallra që në thelb janë abuzive dhe nuk duhet të tregtohen fare (import/eksport/transit). Këto mallra dhe përbërësit e tyre janë të krijuara ose përdoren për ekzekutimin e qenieve njerëzore ose për torturën/keqtrajtimin e tyre;
- mallra të cilat duhet t'i nënshtrohen disa kufizimeve. Këto mallra mund të kenë përdorime të ligjshme, të tilla si pajisjet që përdoren nga autoritetet e zbatimit të ligjit, si dhe kimikate të caktuara farmaceutike, por mund të përdoren edhe për ekzekutimin e qenieve njerëzore ose për torturën/keqtrajtimin e tyre.

Organet kontrolluese shtetërore nuk kanë një informacion dhe nuk kontrollojnë këtë kategori artikujsh.

Nuk ka procedura ndalimi, autorizimi apo lëshimi licence në Republikën e Shqipërisë dhe për këtë arsye nuk ka kontroll mbi tregun për këto mallra.

Mungon përcaktimi i autoriteteve që duhet të mbikëqyrin tregun.

Nuk janë të përcaktuara autoritetet të cilat duhet të japin lejen për këto mallra ose duhet të mbikëqyrin/monitorojnë zbatimin e tij.

Nuk ka masa parandaluese dhe shtrënguese që detyrojnë operatorët të përmbushin detyrimet. Për arsye të mungesës ligjore, nuk ka të përcaktuara rregulla me ndëshkime për marrje të masave të nevojshme. Ndëshkimet duhet të përfshijnë sanksione administrative dhe penale, duke filluar nga gjobat në para deri në burgim, përfshirë konfiskimin e mallrave.

Përdorimi për qëllime çnjerëzore apo aksidente me pasoja për shëndetin e qytetarëve. Produktet të cilat nuk kanë përdorim tjetër, përveç për ekzekutimin e dënimit me vdekje, torturave dhe trajtimeve dhe dënimeve të tjera mizore, degraduese ose çnjerëzore mund të përdoren nga subjekte apo persona të cilët nuk janë të autorizuar dhe mund t'i përdorin këto produkte për qëllime që cenojnë respektin për jetën e njeriut dhe të drejtat themelore të tij.

Gjithashtu, nga përdorimi i mallrave mund të ndodhin aksidente të cilat kanë pasoja për shëndetin e qytetarëve. Shqipëria nuk ka statistika të dedikuara mbi numrin e aksidenteve që janë shkaktuar nga këto mallra, prandaj është e mundur që mund të jenë evidentuar edhe aksidente nga artikujt e futur në treg.

Pikërisht propozimi i këtij projektligji do të adresojë të gjitha problematikat e sipërcituara, duke i dhënë një zgjidhje përfundimtare.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ky projektligj është në harmoni të plotë me rendin e brendshëm juridik dhe atë ndërkombëtar. Përafrimi i kësaj rregullore dhe brendësimi i saj me një akt kombëtar është një hap drejt përafrimit të kuadrit rregullator për disiplinimin e tregtimit, importit dhe eksportit të produkteve që mund të përdoren për dënime kapitale, torturë ose dënime apo trajtime çnjerëzore ose degraduese dhe mallrave ndihmëse të tyre, si shërbime ndërmjetësimi, reklamimi dhe produkte ndihmëse për to.

Duke përafruar Rregulloren (BE) 2019/125 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16.1.2019 “Për tregtinë e disa mallrave që mund të përdoren për dënimin me vdekje, torturën apo trajtime ose dënime të tjera mizore, çnjerëzore apo trajtime ose dënime poshtëruese”. Republika e Shqipërisë do të ketë një rregullim të njësuar me Bashkimin Evropian, për sa i përket regjimit të prodhimit, eksportit dhe importit të produkteve që mund të përdoren për dënimin me vdekje, torturën apo trajtime ose dënime të tjera mizore, çnjerëzore apo trajtime ose dënime poshtëruese.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji synon përafrimin me legjislacionin komunitar, konkretisht me Rregulloren (BE) 2019/125, e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, datë 16.1.2019 “Për tregtinë e disa mallrave që mund të përdoren për dënimin me vdekje, torturën apo trajtime ose dënime të tjera mizore, çnjerëzore apo trajtime ose dënime poshtëruese”. Numri CELEX 32019R0125, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 30/1, datë 31.1.2019, faqe 1-57, i ndryshuar.

Përafrimi do të jetë i pjesshëm dhe do të realizohet i plotë me anë të një vendimi të Këshillit të Ministrave, i cili do të dalë në zbatim të ligjit dhe do të miratojë listat e produkteve të secilës kategori të parashikuar në ligj. Një rregullim i tillë është menduar për të garantuar elasticitet në përditësimin e listave, sipas përditësimeve që kjo e fundit mund të pësojë me

vendimmarrjen e organeve të Bashkimit Evropian, pra për të garantuar një transpozim sa më të shpejtë me procedura më të thjeshtëzuara në krahasim me miratimin e listave me ligj.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Projektligji është i organizuar në 8 krerë, të ndarë në 32 nene, për të adresuar të gjitha çështjet e sipërcituara dhe në zbatim të teknikës legislative është përdorur grupim në krerë. Secili kre dhe nen është titulluar, sipas çështjeve që adreson.

- Kreu I është titulluar “Dispozita të përgjithshme” dhe përcakton objektin dhe përkufizimin e termave të përdorur në projektligj.
- Neni 1 parashikon objektin e këtij projektligji, i cili është konkretisht përcaktimi i rregullave për tregtimin e produkteve që mund të përdoren për dënime kapitale, torturë ose dënime apo trajtime çnjerëzore ose degraduese, si dhe furnizimin me shërbime të ndërmjetësimit, ndihmës teknike, trajnimin dhe reklamën në lidhje me produkte të tilla. Qëllimisht në këtë nen janë përfshirë edhe shërbimet e ndërmjetësimit, ndihma teknike dhe reklamimi i këtyre produkteve si aksesore, të cilët do të ndjekin të njëjtin regjim me mallrat kryesore të cilave i shërbejnë.
- Neni 2 parashikon përkufizimin e termave të përdorura përgjatë projektligjit, të cilat janë unifikuar me ligjet e tjera në Republikën e Shqipërisë, si Kodi Doganor dhe ligji 46/2018 “Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe të artikujve e teknologjive me përdorim të dyfishtë”.
- Kreu II titullohet “Kontrolli mbi mallrat të cilat nuk kanë përdorim praktik përveçse për qëllime të dënimit me vdekje, torturës dhe trajtimit ose dënimeve të tjera, mizore, çnjerëzore apo poshtëruese”. Ky kre ka në bazë të tij ndalimin e eksportit, importit, transitit, ofrimin e shërbimeve të lidhura si ndërmjetësimit dhe reklamimit të mallrave të cilat nuk kanë përdorim praktik, përveçse për qëllime të dënimit me vdekje, torturës dhe trajtimit ose dënimeve të tjera, mizore, çnjerëzore apo poshtëruese.
- Neni 3 trajton ndalimin e eksportit për produktet të cilat nuk kanë përdorim praktik, përveçse mund të përdoren për dënime kapitale, torturë ose dënime apo trajtime çnjerëzore ose degraduese. Gjithashtu, bën përjashtime në rastet kur këto produkte do të përdoren për qëllime muzeore, duke e kushtëzuar këtë eksport me një autorizim paraprak nga AKSHE-ja.
- Neni 4 normon ndalimin e importit të produkteve që përfshihen në objektin e këtij ligji, me të njëjtat përjashtime dhe kushte si në nenin 3.
- Neni 5 trajton kalimin transit të produkteve të sipërpërmendura nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, i cili gjen të njëjtin trajtim si për importin dhe eksportin, të trajtuara nga nenet 3 dhe 4 të projektligjit.
- Neni 6 i projektligjit përcakton ndalimin e shërbimeve të ndërmjetësimit për mallrat të cilat nuk kanë përdorim praktik, përveç përdorimit për dënime kapitale, torturë ose dënime apo trajtime çnjerëzore.
- Neni 7 i projektligjit përcakton ndalimin e asistencës teknike apo trajnimeve mbi përdorimin e produkteve të sipërcituara.
- Neni 8 bën ndalimin e reklamimit dhe ekspozimit të këtyre produkteve, duke detajuar se çfarë do të konsiderohet reklamim dhe ekspozim i produkteve të ndaluara kategorikisht, sipas këtij ligji. Natyrshëm dalim në konkluzionin se edhe reklamimi i disa produkteve që

nuk do të lejohen të prodhohen, eksportohen dhe importohen nuk do të lejohet as të reklamohen dhe ekspozohen nëpër evente publike, si panairot.

- Kreu III i projektligjit titullohet “Kontrolli i mallrave që mund të përdoren për qëllime torture apo trajtime të tjera apo ndëshkime mizore, çnjerëzore apo poshtëruese” dhe rregullon regjimin e trajtimit të mallrave që kanë edhe përdorime të tjera praktike, përveç përdorimit me qëllime torture apo trajtime të tjera apo ndëshkime mizore, çnjerëzore apo poshtëruese. Pra qarkullimi i këtyre mallrave do të jetë subjekt i kontrollit dhe licencimit nga AKSHE-ja.
- Neni 9 rregullon licencën e eksportit dhe të importit për mallrat që mund të përdoren për qëllime torture apo trajtime të tjera apo ndëshkime mizore, çnjerëzore apo poshtëruese. Pika 1 përcakton se cilat mallra përfshihen në detyrimin e pajisjes me licencë import/eksporti. Pika 2 përjashton detyrimin për licencim për kalim transit.
- Neni 10 merret me kriteret që duhet të plotësojë kërkesa për dhënien e autorizimeve për import dhe eksport të mallrave që mund të përdoren për qëllime torture apo trajtime të tjera apo ndëshkime mizore, çnjerëzore apo poshtëruese.
- Neni 11 shtjellon ndalimin e transitit të produkteve të sipërpërmendura nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, nëse ky subjekt ka dijeni se një pjesë e dërgesës ose e gjitha është synuar të përdoret për torturë dhe/ose dënime të tjera mizore.
- Neni 12 trajton autorizimin e shërbimeve dhe përjashtimet e kërkesave për ofrimin e asistencës teknike.
- Kreu IV i projektligjit titullohet “Mallrat që mund të përdoren për dënimin me vdekje”.
- Neni 13 trajton autorizimin për eksport/importin e mallrave në vendet që nuk e kanë shfuqizuar ende dënimin me vdekje. Pika 2 parashikon që autorizimi nuk kërkohet në rastet e kalimit transit në Republikën e Shqipërisë. Pika 3 parashikon përjashtimet nga rregullimet e këtij neni.
- Neni 14 trajton kriteret dhe dokumentacionin që duhet të depozitojë kërkuesi për përfitimin e autorizimeve dhe licencave.
- Neni 15 trajton ndalimin transit në rast se subjekti ka dijeni që pjesë nga dërgesa synohet të përdoret për dënimin me vdekje.
- Neni 16 përcakton procedurat e autorizimit për shërbimet që ofrohen pavarësisht nëse janë me pagesë ose jo. Pika 2 e saj referon në nenin 14 për marrjen e vendimit për kërkesat për autorizim. Ndërsa pika 3 liston rastet dhe përjashtimet nga pika 1 e nenit.
- Kreu V i këtij projektligji titullohet “Llojet e autorizimeve dhe procedurat e lëshimit” dhe përcakton llojet e autorizimeve, autoritetet përgjegjëse.
- Neni 17 trajton llojet e autorizimeve dhe autorizon AKSHE-në për lëshimin e këtyre të fundit. Përcakton periudhën e vlefshmërisë maksimale të llojeve të autorizimeve, si dhe i jep tagrin AKSHE-së për zgjatje afati rast pas rasti, por pa tejkaluar afatin e vlefshmërisë në autorizimet individuale dhe në rastet e shkeljeve të rregullave të parashikuara në draft AKSHE-ja mund të marrë masa.
- Neni 18 trajton lëshimin e autorizimit global, si dhe vlerësimin e autoriteteve nëse importuesi përcakton qëllimin përfundimtar të përdorimit dhe rrezikun e devijimit të mallrave.
- Neni 19 përcakton lëshimin e autorizimit të përgjithshëm, llojet e mallrave që mbulon ky autorizim dhe gjithashtu ofrimin e asistencës teknike.

- Neni 20 rendit kriteret për lëshimin e autorizimeve, përcaktimet që duhet të bëjë kërkuesi, afatet për vendimmarrjen e autoritetit përgjegjës. Ky nen gjithashtu parashikon ankimin në gjykatën administrative kompetente, brenda 30 ditëve nga njoftimi i vendimit.
- Neni 21 parashikon nxjerrjen e një akti nënligjor për miratimin e formateve dhe modeleve standarde të autorizimeve dhe kërkesave për këto dokumente.
- Neni 22 përcakton rastet kur AKSHE-ja refuzon kërkesën për autorizim dhe detyrimin që ka për informimin e kërkuesit.
- Neni 23 liston rastet kur AKSHE-ja është e detyruar të shfuqizojë autorizimin.
- Kreu VI përcakton detyrimet e subjekteve të pajisura me autorizim dhe bashkëpunimin ndërinstytucional.
- Neni 24 trajton bashkëpunimin ndërinstytucional midis organeve shtetërore gjatë procedurave të ndryshme të pajisjes me licenca dhe autorizime. Sipas fushës së përgjegjësisë në procedura të ndryshme marrin pjesë organe të ndryshme të administratës publike. Për shembull në rastin e importit/eksportit të sendeve që do të përdoren për qëllime muzeore, merret mendimi i ministrisë përgjegjëse për muzetë.
- Neni 25 trajton detyrimin e subjekteve, të cilat janë pajisur me autorizime për transferime ndërkombëtare të mallrave që bëjnë pjesë në fushën e veprimit të këtij projektligji, për të ruajtur dokumentacionin për çdo transaksion për një periudhë 10-vjeçare. Ky detyrim vjen si obligim për procedurat e kontrollit që mund të ushtrohen nga organet ligjzbatuese dhe është në analogji me regjimin e trajtimit të këtij dokumentacioni nga legjislacioni i BE-së.
- Neni 26 parashikon detyrimin për raportim të subjekteve të autorizuar te autoritetet përgjegjëse.
- Kreu VII përcakton kontrollin doganor dhe parandalimin e shkeljeve dhe sanksionet.
- Neni 27 trajton kontrollin doganor mbi mallrat objekt i këtij ligji dhe bashkëpunimin e organeve zbatuese të këtij kontrolli dhe AKSHE-ja si organ licencues për transferimet ndërkombëtare të këtyre mallrave. Gjithashtu, trajtohen edhe detyrimet e ndërsjella të secilit organ në rastin e verifikimit të operimit me mallrat subjekt i këtij ligji pa pajisje paraprake me licencën/autorizimin përkatës.
- Neni 28 përcakton se cilat veprime do të konsiderohen shkelje të legjislacionit në fushën e kontrollit të eksporteve. Ky nen është marrë i gatshëm nga ligji 46/2018, duke qenë se trajtojnë të njëjtën çështje, por mallrat e trajtuara nga secili ligj janë të ndryshme.
- Neni 29 trajton sanksionet administrative për shkeljet e parashikuara në nenin 28 të projektligjit.
- Kreu VIII përmban dispozitat kalimtare dhe të fundit.
- Neni 30 parashikon nxjerrjen e një akti nënligjor për çështjet e lëna për detajim nga projektligji. Parashikohet një akt i tillë për të pasur unitet. Afati i lënë është 6 muaj nga hyrja në fuqi e ligjit.
- Neni 31 ngarkon AKSHE-në dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave për zbatimin e këtij ligji.
- Neni 32 i projektligjit parashikon dispozita kalimtare. Ky nen përcakton detyrimin e AKSHE-së për të autorizuar/licencuar me prioritet subjektet të cilat në objektin e aktivitetit të tyre ekonomik kanë pikërisht tregtimin e produkteve objekt të këtij projektligji.
- Ky projektligj parashikohet të hyjë në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohet dhe Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Ky projektligj është hartuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe Autoriteti i Kontrollit Shtetëror të Eksporteve.

Projektligji do të dërgohet për mendim pranë Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj ka efekt financiar në shumën 102.400 (njëqind e dy mijë e katërqind) lekë dhe do të përballohet nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes. Këto kosto janë indirekte, sepse kanë të bëjnë me familjarizimin e personelit dhe me trajnime që do të zhvillohen për të lehtësuar zbatimin e këtij projektligji. Kostoja në vetvete është përlogaritur si orë pune që do të shpenzojë personeli për familjarizim. Pra, si përfundim implementimi i projektligjit nuk do të sjellë efekte mbi buxhetin, por kosto si orë pune të dedikuara në familjarizimin me legjislacionin dhe jo detyrave funksionale të personelit, ashtu si përshkruar në mënyrë shteruese në Raportin e Vlerësimit të Ndikimit (RIA).

PROPOZUESI

MINISTRI I MBROJTJES

Niko Peleshi